

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një në shtatë kinezë përballet me çrregullime mendore, shifrat rriten në tre dekada
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/nje-ne-shtate-kineze-perballet-me-crregullime-mendore-shifrat-rriten-ne-tre-i587095
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 13:57:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 14:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	20e4f9e307f720e392d1fbfa6c59d36067112f3402b149f8684ceba2311c1e3d
TEKSTI	392cc0d398c21f9a283be0341af444e6d018a5634bd1abe78577d5a06d1386b1
PAMJA	8ea23aeac36ea34e03d907ad14f2059cfdc3f661c47513cf36f359711d83822b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	319bc684c2a93469a52f4ece85a32c33e90247ccc9a4735a5e2a9528a6a72437
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/319bc684c2a93469a52f4ece85a32c33e90247ccc9a4735a5e2a9528a6a72437>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



ie [Shperndanin kokaine me makine ne qytetin e Lacit. "Destinacioni" prangos 2 te rinjte nga Tirana dhe Lacit26 etektive te Forcave te Armatosura nisin kursin 3-mujor pro fundit](#)

Një në shtatë kinezë përballet me çrregullime mendore, shifrat rriten në tre dekada



19 Shtator 2026, 16:55Bota TEMA



Gjatë 30 viteve të fundit, në Kinë është shënuar një rritje e çrregullimeve mendore, ku një në shtatë qytetarë përballet me to, raportoi media italiane "La Repubblica".

Një nga librat më të njohur të vitit të fundit në Kinë është shkruar nga psikiatri Jiang Tao, i cili punon në Spitalin Anding të Pekinit, një nga institucionet më të avancuara të vendit në fushën e shëndetit mendor.

Libri titullohet "Qetëso zemrën" dhe gjatë muajve të fundit ka qenë ndër librat më të vlerësuar në Douban, një platformë e njohur kineze ku përdoruesit vlerësojnë libra.

Kjo shihet si një tregues i interesit në rritje të publikut kinez për çështjet e shëndetit mendor.

Në një shoqëri shumë konkurruese si ajo kineze, e cila gjatë dekadave të fundit ka përjetuar ndryshime shumë të mëdha ekonomike dhe sociale, gjithnjë e më shumë njerëz po përballen me probleme të shëndetit mendor.

Një studim i ri, i publikuar së fundmi në "Lancet" nga disa studiues kinezë, tregon se gjatë 30 viteve të fundit në Kinë, është shënuar një rritje e konsiderueshme e çrregullimeve mendore.

Numri i njerëzve që jetojnë me çrregullime mendore në Kinë është rritur ndjeshëm gjatë tre dekadave të fundit, duke arritur në rreth 191,2 milionë raste në vitin 2023, sipas një studimi të ri të publikuar në "The Lancet".

Studimi, i bazuar në të dhënat e "Studimit Global për Barrën e Sëmundjeve (GBD) 2023, analizoi gjendjen e shëndetit mendor në Kinë nga viti 1990 deri në vitin 2023, në nivel kombëtar dhe në 33 njësi administrative të vendit.

Sipas studiuesve, në vitin 2023 shkalla e prevalencës së standardizuar, sipas moshës për çrregullimet mendore ishte 12,706 raste për 100 mijë banorë, rreth

14,6% me e larte se ne vitin 1990.

Numri total i rasteve ishte rritur me rreth 45,6% gjate se njëjtës periudhë, pjesërisht edhe për shkak të rritjes dhe plakjes së popullsisë.

Depresioni dhe çrregullimet e ankthit mbeten ndër problemet kryesore

Sipas studimit, ato përbënin përkatësisht 35,6% dhe 26,3% të barrës së përgjithshme shëndetësore të lidhur me çrregullimet mendore.

Ndërkohë, çrregullimet e të ngrënit shënuan rritjen më të madhe të prevalencës, me 63,4% gjatë periudhës së analizuar.

Autorët vërejnë gjithashtu dallime të konsiderueshme sipas moshës, gjinisë dhe rajonit.

Barra e çrregullimeve mendore ishte veçanërisht e lartë në grupmoshat 5–19, 30–39 dhe 50–59 vjeç.

Gratë kishin barrë më të lartë nga çrregullimet depresive, ndërsa te burrat ishte më e lartë barra e lidhur me autizmin, çrregullimin e hiperaktivitetit dhe deficitit të vëmendjes (ADHD) dhe çrregullimet e sjelljes.

Sipas raportimit të “La Repubblica”, studiuesit e lidhin këtë zhvillim me ndryshimet e mëdha sociale dhe ekonomike të Kinës.

Urbanizimi i shpejtë, konkurrenca në arsim dhe në tregun e punës, përdorimi i gjerë i rrjeteve sociale dhe migrimi masiv, nga zonat rurale drejt qyteteve, mund të kenë krijuar presione të reja psikologjike.

Këto konsiderohen si faktorë të mundshëm, jo si prova se një faktor i vetëm shkakton rritjen e çrregullimeve mendore.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Italia përgatit mision detar në Detin e Kuq: "Nuk mund të presim burokracinë europiane"](#)

15:25 Bota

[Përdhunoj gruan britanike në një rrugë të Londrës dhe më pas e kërkoi në spital, dënohet me 21 vite burg algjeriani](#)

15:15 Bota

Dy dronë të pidentifikuar shkelin hapësirën ajrore të Moldavisë, alarm në Kishinau

15:05 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.